



Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Neni 108 i Ligjit mbi Procedurën Administrative nr.02/L-28, datë 22 korrik 2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (ndryshimin) e vendimit nr. 640/15, datë 13.07.2015 të BPrAL Kolegji “Riinvest”

1. Korrigjohet (ndryshohet) Vendimit i KSHC- nr. 640/15, datë 13.07.2015 i BRrAL Kolegji “Riinvest” në pikën II.
2. Korrigjohet (ndryshohet) pika II e vendimit, si në vijim:

Riakreditohet programet e studimit:

- Menaxhim Biznesi / BA (180 ECTS) (me specializime: Analizë Ekonomike për Biznes; Menaxhment dhe Marketing; Banka, Financa dhe Kontabilitet);
- Menaxhment / MA (120 ECTS) (me specializime: Menaxhment i Përgjithshëm; Banka dhe Financa; Agrobiznes; Marketing; Sistemi i Informacionit për Menaxhment)

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe kërkesën e Kolegjit Riinvest nr. 357/15, datë 10.08.2015 për përmirësim të vendimit të KSHC-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- BRRAL Kolegji "Riinvest"
- MASHT-it,
- Arkivit



Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë